

1.21 Schulbüro

Ihr Schreiben vom:

Ihr Zeichen:

Mein Zeichen: Ti

Dienstgebäude: Kleiner Domhof 6

Zimmer: 1.10

Telefon: 0571 89-750

Fax: 0571 89-680

Auskunft: Ramona Timm

r.timm@minden.de

Regjistrimi i fëmijës tuaj në shkollën fillore(katërvjecare) për vitin shkollor 2022/2023

Të nderuar prindër,

Dita e shumëpritur erdhi - fëmija juaj do të bëhet prej datës 01.08.2022 pjesë e shkollimit të detyrueshm! Për këtë arsye tani është momenti i duhur të regjistroni fëmijën tuaj në shkollën fillore.

Emrin e shkollës ne afërsi të banimit tuaj e gjeni **të përkufizuar** në shkresën gjermanisht. Fëmija juaj ka prioritet regjistrimi në këtë shkollë, për shkak të kapaciteteve mjaftueshme të pranimeve. Në qoftë se ju vendosni për një shkollë tjetër, atëherë fëmija juaj mund të regjistrohet në shkollën e dëshiruar vetëm në rast se atje ka vënde regjistrimi të lira.

Në shkollat „Domschule“ dhe „PRIMUS-Schule“ mund të regjistrohen fëmijë nga të gjitha lagjet ose zonat e qytetit. Në këto shkolla fëmija juaj ka po ashtu prioritet pranimi si në shkollat në afërsi të banimit.

Regjistrimi i fëmijës tuaj në shkollën fillore (katërvjecare) vijon si në katër hapat e mëposhtëm:

- **Plotësimi dhe dërgimi i formularit të regjistrimit („Anmeldebogen“)** Ju lutemi të plotësoni dhe dërgoni nëpërmjet postës ose E-mailit formularin e regjistrimit („Anmeldebogen“) të bashkëngjitur **jo më vonë se data 17.09.2021**. Këtë formular duhet ta dërgoni në zyrën vendore të arsimit të bashkisë Minden.

Dëshironi të regjistroni fëmijën tuaj në një shkollë private (si p.sh. Freie Evangelische Schule, Waldorfschule) ose në një shkollë jashtë territorit të qytetit Minden? Atëherë duhet të kontaktoni shkollën e dëshiruar personalisht. Formularin e regjistrimit ju lutemi ta dërgoni gjithësesi të plotësuar në zyren vendore

të arsimit të bashkisë Minden, edhe nëse ju tashmë keni mbyllur procedurat e regjistrimit të fëmijës.

- **Takimi ditën e regjistrimit**

Shkolla e dëshiruar dhe e zgjedhur prej jush do të informohet dhe ju fton ju si prind personalisht bashkë me fëmijën në një takim/bisedë.

- **Vendimi i pranimit në shkollën përkatëse**

Pas bisedës me prindërit dhe fëmijën, merret vendimi nga drejtoria e shkollës nëse fëmija juaj do të pranohet në shkollë apo jo. Vendimi përfundimtar merret si rregull në fund të Janarit.

- **Kontrolli mjekësor**

Nëpërmjet qendrës shëndetësore të Qarkut Minden-Lübbecke, organizohet për të gjithë fëmijët që bëhen pjesë për herë të parë në arsimin e detyrueshëm një kontroll/vizitë mjekësore. Në këtë kuadër do t'ju dërgohet personalisht një ftesë nga qendra shëndetësore.

Informacione të mëtejshme do të gjeni një pamfletën e bashkangjitur ose në adresën e internetit www.minden.de/schulanmeldung.

Me konsideratë,

Ramona Timm

Dokumentet: Formulari i regjistrimit për vitin shkollor 2022/2023 (Anmeldebogen zum Schuljahr 2022/2023)
Pamfletë informative (Informationspflicht gem. Art. 13 DSGVO + Informationsflyer)

Dokumentet bashkëngjitur janë te disponueshme vetëm në gjuhën gjermane.